

EKSPOZE MBI TEZËN E NIVELIT MASTER
NË INTEGRIME EUROPIANE DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE

**KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT 2008-2020**

NGA

ALBANA BUCALIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

shkurt, 2022

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT 2008 – 2020

Mentor: Prof. Assoc. Dr. Afrim Hoti

Korrupsioni ka ekzistuar dhe ka qenë një problem që nga fillimi i historisë njerëzore. Konsiderohet si një sëmundje që ushqehet në strukturat kulturore, politike dhe ekonomike të shoqërisë dhe shkatërron funksionimin e organeve vitale të shtetit. Në kuptimin e tij tradicional korrupsioni i referohet papastërtisë morale, ku vet fjala rrjedhë nga latinishtja që nënkupton ‘për të prishur, ndotur, abuzuar ose shkatërruar’. Ndërsa, në ditët e sotme korrupsioni nënkupton çdo veprë të pahijshme të lidhur me pozicionin zyrtar të dikujt. Sipas Transparency International korrupsioni përkufizohet si abuzim i pushtetit të besuar për përfitime private.

Janë tre faktorë kyç që i kanë paraprirë historikisht niveleve të larta të korrupsionit në Kosovë:

- sistemi politiko-shoqëror i atëhershëm jugosllav;
- dualizmi pushtetar mes administratës ndërkombëtare dhe institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse vendore pas çlirimit; dhe
- kultura e mosndëshkimit të veprave të korrupsionit.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në Kosovë është një detyrim i përcaktuar në legjislacionin që rregullon deklarimin e pasurisë, konfliktin e interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve, financimin e subjekteve politike dhe të tjera që lidhen me fushëveprimtarinë e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, por njëkohësisht është edhe obligim i cili rrjedhë nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Pyetjet hulumtuese që janë ngritur me fillimin e këtij hulumtimi janë:

1. Cili është kuadri ligjor dhe mekanizmat institucionalë në fuqi në Republikën e Kosovës për luftimin e dukurisë së korrupsionit?
2. Çfarë është arritur dhe cilat janë sfidat e së ardhmes së Kosovës në përballjen me korrupsionin?

Bashkë me pyetjet hulumtuese janë ngritur edhe tri hipoteza:

H1: Kosova përbënë njërin nga shtetet e rajonit, ku proceset demokratike dhe ndërtimi i shtetit ligjor e transparent pengohet në vazhdimësi nga fenomeni i korrupsionit.

H2: Qasja e ‘mbi-institucionalizmit’ ka bërë që Kosova të ketë shumë mekanizma për t’u luftuar korrupsionin me përplasje të mandateve dhe paqartësi mes tyre të cilat kanë shpër në rezultate të dobëta në këtë proces.

H3: Përkundër të gjitha përpjekjeve të Republikës së Kosovës për t’u vënë korrupsionin nën kontroll, niveli i tij (korrupsionit) mbetet ende shumë shqetësues.

Qëllimi kryesor i këtij punimi diplome ka qenë gjetja e kornizës ligjore si dhe e mekanizmave institucionale që janë në fuqi në Republikën e Kosovës për t’u luftuar dukurinë e korrupsionit. Për realizimin e këtij punimi janë përdorur burime sekondare për mbledhjen e të dhënave (libra të autorëve të ndryshëm, artikuj shkencor vendor e ndërkombëtar, raporte të ndryshme, dokumente-ligje të Republikës së Kosovës dhe dokumente të Bashkimit Europian, publikime të organizatave joqeveritare dhe atyre të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, etj.); qasje metodologjike kualitative dhe kuantitative. Në aspektin përmbajtësor të punimit është përdorur metoda përshkruese dhe e analizës.

Punimi është i organizuar të tre kapituj kryesor.

Në kapitullin e parë: është ofruar një përmbledhje e trajtimeve të përgjithshme shkencore të konceptit të korrupsionit ku ofrohen disa përkufizime të autorëve por edhe organizatave të ndryshme mbi korrupsionin. Përveç definimeve, këtu ofrohen edhe llojet, format e manifestimit dhe konceptet e ngjashme me korrupsionin, si dhe disa mënyra se si mund të parandalohet apo kontrollohet ky fenomen.

Në kapitullin e dytë: trajtohet tema bazë e këtij hulumtimi shkencor, pra korniza ligjore dhe institucionale e Republikës së Kosovës në luftën kundër korrupsionit, ku fillimisht trajtohen ligjet dhe strategjitë e hartuara për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri. Ndërsa, në pjesën e dytë trajtohen mekanizmat institucionale të mandatuar për të luftuar korrupsionin, të cilat janë ndarë në institucionet e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Europian për sundimin e ligjit në Kosovë – EULEX.

Në kapitullin e tretë: janë paraqitur disa nga arritjet e shtetit të Kosovës në këtë përballje me

korrupsionin si dhe sfidat e saj aktuale dhe të së ardhmes për të bërë më shumë në këtë fushë.

Përfundimet: në përfundim janë ofruar disa nga gjetjet kryesore të këtij hulumtimi shkencor të cilat lidhen drejt për së drejti me vërtetimin e hipotezave të ngritura qysh në fillim të hulumtimit.